

L I G J
Nr. 8830, datë 5.11.2001

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7796, DATË 17.12.1994,
“MINERAR I SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Pas pikës b) të nenit 69 të ligjit nr.7796, datë 17.12.1994 “Minerar i Shqipërisë” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në raste të veçanta, kur afati i dhënies së lejes minerare të shfrytëzimit kërkohet deri në 99 vjet, ministria përkatëse negocion marrëveshjen me lejekërkuesin, miratimin e së cilës e bën Këshilli i Ministrave.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të miratohet edhe nga Kuvendi.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3153, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani